



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
THE MUNICIPALITY OF ASSEMBLY- SUHAREKA
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), lidhur me neni 17 të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje neneve 15 dhe 29, pika 2, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë -----, miraton këtë:

Projekte-V E N D I M
Për formimin e komisionit

Neni 1

Formohet komisioni për ndarjen dhe definimin e banesave dhe lokaleve afariste në objektin afarist-banesor që do të ndërtohet nga **Bashkim Sali HOXHAI** dhe **z. Sami Dervish ELSHANI** në parcelën kadastrale **P-72116046-01165-5**, të cilëve ju është dhënë në shfrytëzim me Vendimin e Kuvendit të Komunës në Suharekë 01-Nr-016-32543 të datës 29.07.2020 dhe sipas kontratës 01-Nr-016-37358 të datës 19.08.2020 për ndërtimin e objektit afarist-banesore, në këtë përbërje;

- 1.1. -----përfaqësues/e nga Kuvendi i Komunës
- 1.2. -----përfaqësues/e nga Kuvendi i Komunës
- 1.3. -----përfaqësues/e nga Kuvendi i Komunës
- 1.4. -----përfaqësues/e nga Ekzekutivi i Komunës
- 1.5. -----përfaqësues/e nga Ekzekutivi i Komunës

Neni 2

2.1 Detyrat dhe përgjegjësit e komisioni janë që të bëjnë ndarjen dhe definimin e banesave dhe lokaleve afariste që i takojnë Komunës në objektin që do të ndërtohet nga investitorët e cekur më lart në parcelën e cekur në nenin 1 të këtij vendim.

2.2 Komisioni po ashtu të bënë kompensimin dhe barazimin e banesës Nr. 1 me sipërfaqe prej 48.74m² dhe banesës Nr. 2 me sipërfaqe prej 36.56m² me pronar Bashkim Sali Hoxha nga Suhareka, të cilat janë të ndërtuara në parcelën kadastrale P-72116046-01165-6 sipas certifikatës së pronës **nr. 37358-2023** datës 20.01.2023, zona kadastrale Suharekë, vendi i quajtura “Pojata/Slloxa”, e evidentuar pasuri shoqërore në emër të Kuvendit Komunal-Suharekë, e në cilën parcelë ka mu ndërtuar objekti afarist banesore nga investitorët e lartcekur. Kompensimi të bëhet në të njëjtin objekt ku kanë me ndërtuar investitorët në pronë të Komunës së lartcekur.

2.3 Pas arritjes së marrëveshjes përfundimtare të hartojnë marrëveshjen dhe t'i rekomandojnë Kryetarit të Komunës që marrëveshjen ta miraton në Kuvendin e Komunës së Suharekës dhe tek atëherë nënshkruhet nga Kryetari i Komunës me palët investuese.

Neni 3

Autorizohet komisioni i lartcekur që pas ndarjes dhe definimit të banesave dhe lokaleve afariste që i takojnë Komunës, sipërfaqja e lokaleve afariste që i takojnë Komunës të shndërrohen në banesa banimi për Komunën.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

K U V E N D I K O M U N Ë S N Ë S U H A R E K Ë

01-Nr-_____
Me datë_____

Kryesuesi Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI